



Partia
Demokratike

STATUTI I PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË

(Miratuar nga Kuvendi Kombëtar i datës 11 Dhjetor 2021, ndryshuar nga Kuvendi Kombëtar i datës 30 Prill 2022, ndryshuar nga Kuvendi Kombëtar i datës 2 Dhjetor 2023, ndryshuar me vendim të Këshillit Kombëtar të datës 5 Mars 2024 që është ratifikuar nga Kuvendi Kombëtar i datës 30 Maj 2026, ndryshuar nga Kuvendi Kombëtar i datës 30 Maj 2026)

KREU I TË PËRGJITHËSHME

Neni 1 Emri

Partia mban emrin Partia Demokratike e Shqipërisë (PD ose PDSH).

Neni 2 Vlerat themelore politike

1. Partia Demokratike e Shqipërisë (në vijim: PDSH) është parti politike që bashkon në gjirin e saj shtetasit shqiptarë, brënda dhe jashtë vendit, që besojnë, respektojnë dhe mbrojnë:

- a) lirinë dhe demokracinë;
- b) ndërtimin e shtetit të së drejtës, demokratik e social, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin dhe personalitetin njerëzor, si dhe prosperitetin e të gjithë kombit;
- c) vlerat me te larta konservatore patriotike të kombit shqiptar si dhe vlerat themelore të familjes tradicionale në shoqëri;
- ç) shenjtërinë e pronës private;
- d) dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare si një mision i vazhdueshëm;
- dh) humanizimin e solidaritetin shoqëror dhe frymën e tolerancës e të bashkëjetesës fetare;
- e) vlerat, parimet dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s;
- ë) aspiratën për integrimin e plotë europian të Shqipërisë, nëpërmjet jetësimit të dëshirës së përhershme, qasjes perëndimore dhe thirrjes së brendshme të anëtarëve të saj “Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa”;
- f) drejtësinë, paqen, harmoninë dhe bashkëpunimin ndërmjet kombeve, si vlerat më të larta të njerëzimit.

2. PDSH-ja është parti e interesit kombëtar dhe e vokacionit perëndimor të shqiptarëve. Ajo mbron dhe promovon interesat e Shqipërisë dhe shqiptarëve:

- a) pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kombëtare;
- b) të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- c) zhvillimin e nismës së lirë e barazinë në shanse, tregun e lirë e konkurrencën si mjet të zhvillimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit;
- ç) sigurinë e individit e të pronës;
- d) drejtësinë shoqërore e dialogun social;
- dh) paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror;
- e) ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit;

- ë) autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen lokale;
- f) meritokracinë dhe shanset e barabarta në punësim dhe karrierë, duke nxitur një administratë publike të qëndrueshme dhe profesionale;
- g) luftën ndaj korrupsionit dhe dhënies fund të fenomenit të pandëshkueshmërisë;
- gj) shkëputjen e lidhjeve midis politikës dhe krimit të organizuar, përmes dekriminalizimit të plotë të jetës politike dhe publike.

3. PDSH-ja është anëtare e Partisë Popullore Europiane dhe Bashkimit Demokrat Ndërkombëtar Ajo udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga të njëjtat vlera e parime që ajo ndan me partitë simotra të këtyre organizatave.

Neni 3 Qëllimet politike

1. PDSH-ja njeh dhe promovon pjesëmarrjen e gjerë popullore në jetën politike, shoqërore dhe në institucione, si dhe kujdeset për formimin e një vullneti të gjerë e të qëndrueshëm popullor në dobi të mbrojtjes dhe zhvillimit të traditave më të larta shoqërore, politike dhe kulturore të shqiptarëve, në dobi të realizimit dhe zhvillimit të shpejtë të aspiratave euroatlantike të Shqipërisë, si dhe rrezatimin pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë, për përjetësimin e kombit shqiptar, identitetin e kulturës së tij.

2. PDSH-ja udhëhiqet nga vlerat tradicionale të spektrit të djathtë: liria, demokracia, besimi te Zoti, patriotizmi, familja tradicionale dhe vlerat e saj dhe shenjtëria e pronës private. Në thelb të filozofisë së saj qëndron interesi kombëtar, liria dhe dinjiteti i individit, konkurenca e ndershme dhe meritokracia.

3. PDSH-ja i realizon objektivat e veta politike nëpërmjet komunikimit e angazhimit politik, publik dhe përmes pjesëmarrjes në zgjedhje, në përputhje dhe respektim të plotë të kuadrit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Shqipërisë.

4. PDSH-ja synon:

- a) të ndërtojë një rend kushtetues demokratik të bazuar në liri dhe drejtat themelore të individit të njohura e të marra në mbrojtje nga dokumentet ndërkombëtare, tregun e lire të mbështetur në bashkësinë e njerëzve të lirë, të përgjegjshëm, që bashkëpunojnë, respektojnë e ndërmarrin përgjegjësi të përbashkëta;
- b) të ndërtojë shtetin ligjor me raporte të balancuara e të ndara qartë të pushteteve, garant të jetës, lirive dhe të drejtave të sanksionuara me ligj të qytetarëve;

- c) të zhvillojë ekonominë e tregut nëpërmjet nxitjes së nismës së lirë ekonomike e shtimit të pronës private si forma mbisunduese në krijimin dhe pronësimin e pasurisë kombëtare, nëpërmjet privatizimit të ndërmarrjeve ekonomike publike, liberalizimit të tregut e licencimeve, zbatimit të politikave favorizuese fiskale, taksave të ulta dhe qeverisjen e vogël dhe efikente;
- ç) të garantojë të drejtën e pronës private, paprekshmërinë e saj dhe të drejtën e pronarëve për ta zotëruar atë lirisht, trashëguar apo dëmshpërblyer me vlerë të plotë tregu;
- d) të përfaqësojë interesat e grupeve shoqërore të të përndjekurve politikë dhe pronarëve të ligjshëm të shpronësuar gjatë regjimit komunist, duke promovuar, ndërmarrë dhe zbatuar çdo normë ligjore, që garanton vendosjen e drejtësisë dhe rikthimin e dinjitetit të munguar, si dhe duke korigjuar të gjitha pasojat financiare të padrejtësive të bëra ndaj tyre gjatë komunizmit;
- dh) të zhdukë privilegjet dhe pabarazitë që nuk përlicojn as nga puna e prona, as nga talenti e as nga shërbimet e kryera ndaj vendit;
- e) të promovojë respektimin e barazisë gjinore në jetën e partisë dhe pjesëmarrjen e grave në organet e zgjedhura dhe ato ekzekutive;
- ë) të integrojë Shqipërinë si anëtare dinjitoze në Bashkimin Europian;
- f) të garantojë sigurinë kombëtare dhe të kontribuojë si vend anëtar i NATO-s dhe në bashkëpunim me institucionet europiane, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të tjera organizma ndërkombëtarë për të siguruar paqen, lirinë, demokracinë, garancinë ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit për të gjithë rajonet dhe më gjerë;
- g) të mbrojë interesat kombëtare dhe të drejtat njerëzore të shqiptarëve kudo që janë, duke respektuar aktet e marrëveshjet ndërkombëtare dhe duke kërkuar standardet e pranura botërisht për të gjithë;
- gj) të zhvillojë mardhënie vëllazërore me Kosovën dhe partitë politike simotra të shqiptarëve në vendet tjera.
- h) të nxisë një sistem drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, që i shërben vetëm qytetarëve dhe interesit publik.

5. Qëllimet politike dhe vlerat themelore politike të PDSH-së detajohen dhe pasqyrohen në programin e saj, si dhe në dokumente të tjera që miratohen në përputhje me Statutin nga organet e saj qendrore, si dhe janë të detyrueshme për zbatim në çdo vendimarrje, veprimtari apo aksion politik të PDSH. Kuvendi Kombëtar ose Këshilli Kombëtar dhe referendumi i antarsisë së PDSH-së miratojnë rezoluta me fuqi detyruese ose orientuese për PDSH-në, për çështje me rëndësi themelore politike dhe/ose me ndikim elektoral.

Neni 4 **Selia Qendrore**

PDSH e ka qendrën e saj në Kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Neni 5 **Organizimi i partisë**

1. PDSH-ja është një organizim politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë në strukturat e saj, të organizuara në nivel kombëtar dhe lokal.
2. Organizimi në nivel lokal bëhet mbi bazën e një prej kriterëve të mëposhtem:
 - a) ndarjes territoriale administrative të vendit;
 - b) njësive bazë elektorale;
 - c) mbi baza socio-profesionale;dhe/ose
 - ç) mbi baza përfaqësimi të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.
3. Struktura organizative e partisë në nivel lokal përcaktohet me vendim të Kryesisë së PDSH-së, mbi bazën e kriterëve specifike apo rrethanave të caktuara, sipas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm të PDSH.

Neni 6 **Simboli**

Simboli i PDSH është në formë rrethore dhe paraqet një lëvizje graduale që fillon nga “asgjëja” që më pas shndërrohet në një linjë të plotë që udhëton drejt qendrës së logos, duke vizatuar shkronjat “P” dhe “D” të cilat janë inicialet e partisë. Ngjyra e linjës është blu e thellë mbi sfond të bardhë. Gjithashtu ngjyrat e kundërta janë linjë e bardhë dhe sfondi blu i errët. Ky simbol përdoret nga organet përfaqësuese të PDSH ose me autorizim të tyre.

Neni 7 **Flamuri**

Flamuri i PDSH është me ngjyrë blu, në qendër të të cilit ndodhet simboli i saj në ngjyrë të bardhë, sipas aneksit bashkëlidhur këtij Statuti.

Neni 8 **Vula**

1. Vula e partise eshte ne forme rrethore. Ne mes te vules eshte i vendosur simboli i partise dhe eshte i rrethuar me emrin e plote te partise me llojin e germave specifike ne gjatesine 75 perqind te perimetrit te rrethit. 25 perqind

i perimetrit të rrethit perbehet nga linje në trashesine e lartësisë së shkronjave që është shkruar emri i partisë. Keta dy elemente perbejne rrethin e plote rreth simbolit të partisë.

2. Vula përdoret vetëm në emër të Organeve Qendrore të PDSH dhe administratës ekzekutive të Selisë Qendrore. Degët e PDSH në rrethe kanë vulat e tyre që ruajnë modelin e mësipërm duke shtuar emërin përkatës të degës.

3. Rregullat e përdorimit të vulës caktohen nga Kryesia.

Neni 9 Bazat e funksionimit

Funksionimi i PDSH-së bazohet në:

1. demokracinë e brëndshme, e shprehur përmes votës së anëtarëve të saj. Shprehja e vullnetit të antarëve bëhet drejtpërsëdrejti ose përmes përfaqësuesve të mandatuar prej tyre. Në çdo institucion kolegjal të PDSH si rregull, numri i anëtarëve të zgjedhur është të paktën dy herë më i madh se ai i anëtarëve për shkak të funksionit. Shprehja e vullnetit në mënyrë të drejtpërdrejtë bëhet përmes parimit “një antar një votë” dhe/ose referendumit,
2. lirinë e shfaqjes së mendimit, e cila është e garantuar në çdo mbledhje të strukturave të partisë apo veprim të PDSH-së. Çdo anëtar është i lirë të shprehë mendimin dhe propozimin e tij për përmirësimin e punës apo veprimeve politike të PDSH-së.
3. njohjen dhe garantimin e krijimit, funksionimit e fraksioneve brënda saj. Fraksionet organizohen mbi baza ideologjike dhe/ose programore si dhe kur mbështeten nga jo më pak se 15% e degëve, deputetëve, ose antarëve të Këshillit Kombëtar të PDSH-së.
4. kolegjalitetin në marrjen e vendimeve, duke respektuar përfshirjen e të gjithë anëtarëve, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, në çdo vendim apo veprim politik të PDSH-së. Organet dhe funksionarët e partisë gjatë veprimtarisë së tyre përfaqësojnë dhe i shërbejnë vullnetit të anëtarëve, si dhe tërheqin dhe parashtrojnë mendimin e anëtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë partiake, përfshirë edhe mendimet ndryshe.
5. ndarjen e pushteteve dhe hierarkinë e organeve vendimmarrëse brënda partisë.
6. transparencën në vendimmarrje dhe në veprimtarinë politike të PDSH-së, duke informuar anëtarët dhe simpatizantët mbi to. Mbledhjet dhe veprimtaria e organeve të partisë është e hapur për anëtarët e saj, me përjashtim të rasteve, kur shumica e anëtarëve të organit vendos ndryshe, me qëllim ruajtjen e karakterit konfidencial të mbledhjes apo veprimtarisë. Në çdo rast, vendimet që merren dhe dokumentet që pasqyrojnë veprimtarinë e organit përkatës, u

bëhen të njohura anëtarëve të partisë nëpërmjet strukturave organizative të partisë, dhe/ose mjeteve të informimit publik.

7. shanset e barabarta në pjesëmarrje dhe përfaqësimin midis grave dhe burrave, duke synuar dhe nxitur që në cdo organ apo nivel, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave të jetë gjer në 40 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në atë organ apo nivel përfaqësimi.

8. solidaritetin dhe mbështetjen midis anëtarëve dhe strukturave drejtuese të partisë. Anëtarët e PDSH-së, të organizatave të saj partnere si dhe simpatizantët e tyre, veprojnë në bashkëpunim dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Organet qendrore të PDSH-së, si dhe strukturat e saj ekzekutive, kujdesen për marrjen në mbrojtje të anëtarëve, simpatizantëve dhe mbështetësve të tyre nga çdo pasojë e mundshme që rrjedh prej pjesëmarrjes në veprimtarinë politike të kryer në përputhje me këtë Statut, apo bindjeve të tyre politike.

Neni 10

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

1. Çdo anëtar që përmbush kushtet e parashikuara në këtë Statut, apo kriteret e posaçme për një funksion partiak të caktuar, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Vota e çdo anëtari është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

2. Organizimi i brendshëm i partisë bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të fshehta, të barabarta, dhe periodike. Mandati i organeve të PDSH është katër vjet.

3. Procesi zgjedhor brënda partisë, garanton parimin e konkurrencës të lirë dhe shanseve të barabarta midis kandidatëve, sipas kriterëve të shpallura dhe të njohura paraprakisht. Kandidatëve për çdo organ të partisë u garantohej e drejta e barabartë në procesin zgjedhor dhe kontrollin mbi mënyrën e realizimit të tij. Realizimi i çdo procesi zgjedhor brënda partisë udhëhiqet nga parimet demokratike dhe transparenca.

4. Karriera e çdo anëtari dhe/ose simpatizanti të PDSH-së, në funksionet brënda organeve të partisë apo funksionet politike përfaqësuese dhe/ose shtetërore, bazuar në meritokracinë dhe kontributin politik, elektoral dhe profesional të tij, është e garantuar. Zgjedhja apo caktimi në këto funksione bëhet bazuar në kohëzgjatjen e anëtarësisë në parti apo shfaqjes si simpatizant i saj; kontributit në fushata elektorale; kontributit profesional e politik në parti, si dhe në promovimin e vlerave themelore që udhëheqin PDSH-në; aktivizimit në jetën politike e publike të vendit; mbrojtjes në vazhdimësi të interesave, vlerave dhe programit të PDSH-së; si dhe reputacionit në radhët e anëtarësisë dhe/ose shoqërisë në tërësi.

5. Në çdo organ të partisë, numri i anëtarëve të zgjedhur duhet të jetë më i madh se numri i atyre që hyjnë drejtpërdrejt si anëtarë të organit për shkak të funksionit të tyre.

6. Rregullat e hollësishme për të garantuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, kriteret e posaçme për çdo funksion politik brënda partisë apo për përfaqësimin politik në organet qendrore apo lokale, si dhe rregullat që garantojnë një proces zgjedhor demokratik dhe transparent, përcaktohen në Rregulloren e Brendëshme të partisë dhe/ose udhëzimet e nxjerra sipas këtij Statuti.

Neni 11 Referendumi

1. Për çështje të një rëndësie të veçantë, në Partinë Demokratike thirren dhe mbahen referendume, në të cilat thirret për të votuar e gjithë anëtarësia e PDSH me të drejtë vote.

2. Çështja që shtrohet për zgjidhje në referendum duhet të jetë e formuluar thjesht dhe qartë, përgjigja e të cilës mund të jepet me "Po" ose "Jo". Çështja që shtrohet për zgjidhje në referendum, konsiderohet e miratuar kur për të votojnë "po" më shumë se gjysma e anëtarëve të PD të cilët kanë marrë pjesë në votim.

3. Referendumi mund të thirret nga Kuvendi Kombëtar, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH, si dhe të kërkohet nga jo më pak se 7.000 (shtatë mijë) antarë të Partisë. Në këtë rast, Kryesia e Partisë, pas verifikimit nga Sekretariati të numrit dhe saktësië së nënshkrimeve, është e detyruar të thërrasë referendumin për të njëjtin motiv të përcaktuar nga kërkesa e anëtarësisë pa ndryshuar formulimin e çështjes që shtrohet për zgjidhje.

Ne rast se Kryesia nuk përmbush detyrimin e saj, kërkuesit caktojnë një grup *ad hoc* prej 10 antarësh të cilët verifikojnë firmat e kërkuesve, i bëjnë ato publike, si dhe caktojnë datën e referendumit e cila duhet të jetë jo më herët se 30 ditë nga data e publikimit të listës së kërkuesve të referendumit.

4. Përgjegjësia e organizimit dhe mbajtjes së referendumit, pavarësisht nga mënyra e thirrjes së tij, është në çdo rast e Kryesisë së Partisë.

Në rast se kryesia nuk e përmbush detyrimin e saj, grupi nismëtar ka të drejtë të shtojë shkarkimin e Kryesisë në çështjet për votim në referendum.

5. Rregulla më të detajuara lidhur me referendumet përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të PDSH.

Neni 12

Përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhjet parlamentore dhe vendore

1. Kandidaturat elektorale të PDSH-së për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe/ose pushtetin vendor evidentohen nëpërmjet:

- a) vetëpropozimit;
- b) propozimit nga antarësia;
- c) propozimit nga organet qendrore të PDSH-së.

1/1. Kandidaturat e evidentuara sipas pikës 1, i nënshtrohen verifikimit dhe përzgjedhjes paraprak të Komisionit të Seleksionimit të Kandidaturave, një organ kolegjal që ngrihet me vendim të Kryesisë së PD, sa herë ka procese të seleksionimit të kandidatëve për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe/ose pushtetin vendor.

Komisioni përbëhet nga të paktën 5 anëtarë, të cilët duhet të jenë figura me një karrierë të gjatë në PD, jashtë kushteve të konfliktit të interesit, apo me angazhim të spikatur në shoqërinë civile ose botën akademike. Ata veprojnë në mënyrë të pavarur nga organet drejtuese të Partisë dhe i nënshtrohen vetëm rregullave të përcaktuara në Statut apo aktet nënligjore të miratuara në përputhje me të.

Komisioni është përgjegjës për seleksionimin paraprak të kandidatëve, bazuar në të dhënat e plotë që provojnë pastërtinë e figurës, arsimimin, aktivizimin në jetën publike dhe mbrojtjen e interesave dhe programit të PD-së, reputacionit në radhët e anëtarësisë së partisë dhe komunitetit ku jetojnë, kontributit profesional e politik në parti apo shoqëri, kontributit në fushata elektorale dhe kohëzgjatjen e anëtarësimit në parti.

Vetëm kandidatët që kalojnë me sukses filtrin e Komisionit të Seleksionimit të Kandidatëve, mund të nënshtrohen procesit sipas pikës 2 të këtij neni. Rregullat e detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Seleksionimit të Kandidaturave, si dhe për procesin që realizohet prej tyre në përzgjedhjen paraprake të kandidatëve, përcaktohen me vendim të Kryesisë së PD.

2. Seleksionimi dhe përzgjedhja e kandidaturave elektorale bëhet me votim nga antarësia, bazuar në sistemin e primareve, rregullat e detajuara të të cilit miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar të PDSH-së. Ky proces duhet të kryhet dhe të ketë përfunduar jo më vonë se 6 muaj përpara datës së dekretuar zyrtarisht për zgjedhjet e përgjithshme apo vendore.

3. Lista përfundimtare e kandidaturave elektorale të PDSH-së miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar, sipas propozimit të Kryesisë së PDSH-së.

4. Kryetari ose sekretari i Degës kur dëshirojnë të jenë në rrethin e kandidatëve elektoral për pushtetin qendror ose vendor, duhet t'i paraqesin dorëheqjen me

shkrim Kryesisë së PD, jo më vonë se 6 muaj përpara datës së zhvillimit të procesit sipas pikës 2. Përtej këtij afati kandidatura bëhet e pakualifikueshme. Kryesia e PD ndërhyr menjëherë për të komanduar Kryetarin e ri të Degës apo për të emëruar sekretarin e ri të Degës. Kryetari apo sekretari i dorëhequr nuk mund të kandidojnë më në zgjedhjet pasardhëse për Kryetar apo sekretar të Degës.

Neni 13

Format e veprimit dhe bashkëpunimit

1. Partia Demokratike e Shqipërisë për realizimin e synimeve të saj vepron nëpërmjet:

- a) veprimtarisë së anëtarëve të saj, organeve lokale e qendrore, strukturave ekzekutive;
- b) zbatimit të platformës dhe programeve të saj kur qeveris e vetme ose në koalicion si dhe nëpërmjet qeverisjes lokale që përfaqëson PDSH-jë;
- c) grupit parlamentar;
- ç) organizatave partnere dhe organizatave e shoqatave të tjera të afërta me PDSH-në;
- d) bashkëpunimit me partnerë të huaj, organizata e institucione ndërkombëtare.

2. PDSH-jë, për realizimin e objektivave dhe funksioneve të saj përdor mediat publike dhe private, dhe çdo formë tjetër komunikimi publik, manifestime e protesta, takime të hapura e tubime, konferenca e seminare, si dhe çdo formë tjetër të ligjshme.

Neni 14

Veprimtaritë publike

1. PDSH në përputhje me legjislacionin në fuqi organizon, për qëllime të realizimit të objektivave të veta të ligjshme dhe promovimit të vlerave të saj themelore, edhe veprimtari ekonomike, studimore, klube, institute, apo forma të tjera të organizimit shoqëror.

2. Veprimtaritë e PDSH-së janë si rregull publike, me përjashtim të rasteve, kur vlerësohet se mund të dëmtohet interesi politik i saj. Ato zhvillohen si brënda territorit të vendit, ashtu edhe jashtë tij në respektim të legjislacionit të vendeve përkatëse.

Neni 15

Aftësia vendimmarrëse e organeve kolegjiale të PDSH-së

1. Organet e Partisë kanë aftësi vendimmarrëse kur janë thirrur sipas rregullave të parashikuara në këtë Statut, si dhe kur në mbledhje kanë marrë pjesë mbi 50% e anëtarëve me të drejtë vote, me përjashtim të rasteve, kur në Statut parashikohet një shumicë e cilësuar për marrjen e vendimeve.
2. Në rast se në mbledhje nuk janë të pranishëm anëtarët e nevojshëm për të siguruar shumicën e kërkuar për vendimmarrje, drejtuesi i mbledhjes nuk duhet të fillojë mbledhjen dhe njofton shtyrjen e mbledhjes për një datë dhe orë tjetër. Në këtë rast, ai mund të mos marrë parasysh afatet e përcaktuara në Statut.
3. Në përcaktimin e numrit të nevojshëm për të siguruar aftësinë vendimmarrëse llogariten edhe abstenimet dhe/ose votat e pavlefshme.

Neni 16

Shumica e kërkuar për vendimmarrje

1. Vendimet miratohen me shumicën e votave të pjesëmarrësve në votim, me përjashtim të rasteve, të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i refuzuar.
2. Për ndryshime statutore nevojitet shumica e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote të Kuvendit.
3. Për miratimin e vendimit për shpërndarjen apo bashkimin e PDSH-së me një parti tjetër si dhe të ndryshimit të emrit të saj, duhet një shumicë prej 3/4 e votave.

Neni 17

Llojet e votimit

1. Votimi bëhet i hapur duke ngritur dorën ose mandatin.
2. Votimi bëhet i fshehtë në rastet e përcaktuara nga Statuti, si edhe kur propozimi për votim të fshehtë mbështetet nga 1/5 e anëtarëve me të drejtë vote. Shkelja e rregullit për votim të fshehtë passjell pavlefshmërinë e votimit.

Neni 18
Afatet e zgjedhjeve

Të gjitha organet e Partisë duhet t'u nënshtrohen zgjedhjeve periodike, si rregull çdo katër vjet.

KREU II
ANËTARËSIA

Neni 19
Kushte dhe kriteret e anëtarësisë

1. Anëtar i PDSH mund të jetë, çdo shtetas shqiptar që:
 - a) është mbi 15 vjeç;
 - b) pranon kushtet e anëtarësimit dhe përkrah e mbrojnë vlerat themelore të PDSH;
 - c) nuk është, në momentin e anëtarësimit, anëtar i partive politike, apo i organizatave që nuk janë në partneritet të deklaruar e pranuar nga PDSH.
2. Konsiderohen anëtarë të PDSH, me të drejtë për të zgjedhur apo për t'u zgjedhur, të gjithë ata që:
 - a) kanë bërë anëtarësimin e tyre individual dhe janë pranuar e regjistruar si anëtar jo më vonë se 6 muaj përpara datës së zgjedhjes ku ai merr pjesë;
 - b) kanë paguar kuotën vjetore të anëtarësisë në masën e caktuar me vendim të Kryesisë së PDSH.
 - c) ndaj tyre nuk është marrë masa disiplinore e përjashtimit apo pezullimit nga partia apo nuk kanë dhënë dorëheqjen.
 - d) marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve ku bëjnë pjesë.
3. Mospagimi për 2 vjet rrjesht i kuotës së anëtarësisë, si dhe mospjesëmarrja për gjashtë muaj në mbledhje të njëpasnjëshme të organeve ku bën pjesë, pa shkaqe të përligjura, sjell humbjen e të drejtës së votës si anëtar i PDSH, me vendim të Kryesisë së Degës. Personi që ka humbur të drejtën e votës mund të ankohet në Komisionin e Apelit dhe Vlerësimit të Statutit sipas përcaktimeve në Rregulloren e Brendëshme.

Neni 20
Pranimi i anëtarit të PD

1. Kërkesa për anëtarësim duhet të paraqitet me shkrim duke plotësuar formularin përkatës:
 - a) në seksionin e Partisë të vendbanimit faktik të kërkuesit;
 - b) në degën e PD;

- c) në selinë qendrore të Partisë Demokratike;
- d) në formë elektronike në faqen ëeb të PD.

Pranimi në seksionin apo degën e PD bëhet vetëm për anëtarët që banojnë në territorin përkatës.

Konfirmimi i pranimit të anëtarit të PD bëhet nga Dega e PD. Pas pranimit, anëtari i ri pajiset me dokumentin e anëtarësisë nga dega përkatëse.

2. Në rast refuzimi të kërkesës, personi mund të ankohet në organin epror më të afërt të organit që ka hedhur poshtë kërkesën, vendimi i të cilit mund të ankimohet në Komisionin e Apelimit dhe Vlerësimit të Statutit.

Neni 21

Regjistri i anëtarësisë

1. Evidentimi i anëtarëve të Partisë Demokratike bëhet në Regjistrin Bazë të Anëtarësisë në format elektronik dhe shkresor, i cili përmban të dhënat e përditësuara për të gjithë anëtarët e regjistruar në Partinë Demokratike, pavarësisht momentit të antarësimit të tyre. Regjistri i nënshtrohet procesit të përditësimit të paktën cdo dy vjet, sipas rregullave të miratuara me udhëzim të Kryesisë së PD.

2. Të dhënat personale të cdo anëtari, përdoren vetëm për qëllime të ligjshme dhe për veprimtari brenda Partisë nga personat e autorizuar dhe sipas përgjegjësive që cakton ky Statut. Ato administrohen dhe mbrohen me standardet më të larta të sigurisë, të parshikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Rregullat e hollësishme për formatin e regjistrit, administrimin, përditësimin dhe aksesimin e tij, përcaktohen me udhëzim të Kryesisë së Partisë.

Neni 22

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit

1. Anëtari i PDSH ka të drejtë:

- a) të marrë pjesë në mbledhjet dhe zgjedhjet sipas Statutit si dhe në çdo veprimtari të PDSH dhe të shprehë aty lirisht mendimin e tij;
- b) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Partisë;
- c) të propozojë për të gjitha organet legjislative e ekzekutive që përfaqësojnë PDSH sipas kushteve që parashikohen në këtë Statut, si dhe mund t'u drejtohet për çështje vetjake e të Partisë të gjitha organeve drejtuese të saj.

2. Anëtari i PDSH ka për detyrë:

- a) të jetë aktiv në veprimtarinë politike e elektorale të PDSH dhe të ndjekë jetën e brendshme organizative të saj.
- b) t'i paguajë Partisë kuotën vjetore të anëtarësisë. Masa e kuotës vjetore dhe rregullat për shpërndarjen e saj ndërmjet selisë qendrore dhe strukturave lokale përcaktohen me vendim nga Kryesia e PDSH.
- c) të paguajë kuotën e anëtarësisë brënda 60 ditëve nga data e thirrjes për pagimin e saj. Me përfundimin e afatit të njoftuar për pagimin e kuotës, anëtarët që nuk kanë paguar atë, humbasin të drejtën e votës, deri në shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura.
- d) të respektojë disiplinën e Partisë të përcaktuar në këtë Statut dhe në aktet politike të shpallura nga PDSH.

3. Anëtarët e Partisë nuk mund të jenë njëkohësisht në më shumë se dy kryesi të organeve të Partisë pavarësisht nga niveli i tyre, me përjashtim të rasteve të pjesëmarrjes për shkak të funksionit që mban. Përkatesia në kryesitë e organizatave partnere nuk merret në këtë rast në konsideratë.

Neni 23

Përfundimi i anëtarësisë

- 1. Anëtarësia përfundon kur anëtari vdes, largohet me kërkesën e tij, përjashtohet ose përfaqëson ose rrjeshtohet me subjekte të tjera politike në gara elektorale.
- 2. Çdo anëtar mund të largohet nga Partia me vullnetin e tij, duke njoftuar seksionin ku bën pjesë ose organin ku është i zgjedhur.

Neni 24

Masat disiplinore

- 1. Thyerja e disiplinës së brendshme të Partisë, ndërmarrja e veprimeve, në çdo formë apo mënyrë, që dëmtojnë interesat elektorale apo politike të PDSH, dhe mosplotësimi i detyrimeve të anëtarësisë sjell sanksione dhe kufizime të të drejtave të anëtarit të PDSH.
- 2. Masat disiplinore që mund të merren ndaj anëtarëve janë: paralajmërimi, pezullimi dhe përjashtimi. Këto masa merren sipas rastit nga Kryesia e Degës ose Kryesia e PDSH, dhe mund të apelojnë përpara Komisionit të Apelit dhe Vlerësimit të Statutit. Ato mund të bëhen publike.
- 3. Në tre muajt që paraprijnë çdo fushatë zgjedhore dhe një muaj pas saj, Kryesia e Partisë mund të deklarojë kundërt një anëtar, kushdo qoftë funksioni i tij, njërin prej sanksioneve që parashikon Statuti, nëse ai pengon zbatimin e

vendimeve që kanë të bëjnë me kandidaturat në zgjedhje. Ky vendim është i ankimeshëm dhe shqyrtohet nga Komisioni i Apelimit dhe Vlerësimit të Statutit brenda 5 ditëve nga marrja e ankimit.

4. Kërkesat për ripranim shqyrtohen nga kryesitë e rretheve, nëse vendimet janë marrë prej tyre, ose nga kryesia e partisë për të gjitha rastet e tjera.

5. Rastet që përbëjnë shkelje disiplinore, si dhe rregullat e procedurave dhënies së sanksioneve përkatëse disiplinore për anëtarët përcaktohen në Rregulloren e Brendshme.

Neni 25 Simpatizantët

1. PDSH quan simpatizant të saj çdo qytetar që mbështet politikën apo veprimtarinë e saj dhe voton për të. Ajo nxit pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë publike dhe politike të saj.

2. Për evidentimin e simpatizantëve të PDSH krijohet Regjistri Bazë i Simpatizantëve në format elektronik, i cili përmban të dhënat e përditësuara në mënyrë periodike për të gjithë simpatizantët e PDSH. Të dhënat hartohen nga Kryetari i Seksionit, nën përgjegjësinë e Kryetarit të Grupseksionit, dhe i nënshtrohen përditësimit të paktën çdo 2 vjet.

3. Simpatizantët e PDSH pajisen me dokumentin e simpatizantit. Ata gëzojnë të drejtë vote në përzgjedhjen nëpërmjet primareve të kandidaturave të degës së PD për Kuvendin dhe organet e qeverisjes vendore.

4. Rregullat e hollësishme për formatin e regjistrit, administrimin, përditësimin dhe aksesimin e tij, përcaktohen me udhëzim të Kryesisë së Partisë.

KREU III ORGANIZIMI VENDOR I PARTISË

Neni 26 Organizimi bazë i Partisë

1. Organizimi bazë i PD bëhet mbi bazën e njësive territoriale administrative, njësive elektorale, në nivel kombëtar mbi bazën e kriterëve specifike, ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbi bazën e rajoneve brenda një shteti apo në tërësi për një shtet.

2. Njësitë organizative të PD janë:

- a) Seksionet
- b) Grupseksionet
- c) NënDegët e Partisë Demokratike
- d) Degët e Partisë Demokratike
- e) Degët e Partisë Demokratike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 27 Seksioni

1. Seksioni është njësia bazë organizative e Partisë. Ai organizohet mbi bazë territoriale të qendrave të votimit.

Në raste të vecanta seksioni organizohet edhe në nivel dege ose kombëtar mbi bazë specialitetesh, gjendjeje shoqërore e profesionale, studentore, shkollore, moshore, ose në internet e emigracion me vendim të Kryesisë së Partisë ose Kryesisë së Degës. Çdo seksion i partisë përfaqësohet nga kryesia e tij.

Kryesia e Degës përgjigjet për koherencën e organizimit në territorin përkatës të partisë dhe informon kryesinë e Partisë.

2. Krijimi, shkrirja, bashkimi ose ndarja e seksioneve vendoset nga Kryesia e Degës përkatëse.

3. Seksioni drejtohet dhe përfaqësohet nga Kryetari, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Brendëshme.

4. Kryetari, nënkryetari dhe sekretari zgjidhen cdo katër vjet, me votim të fshehtë, nga mbledhja e të gjithë anëtarëve të seksionit, sipas parimit “Një anëtar, Një votë”. Numri i kandidaturave që i nënshtrohen votimit duhet të jetë, si rregull, të paktën dy për cdo pozicion. Kryetari nuk mund të zgjidhet më shumë se dy herë radhazi në drejtim të seksionit, në rast se rezultati zgjedhor i qendrës përkatëse të votimit vlerësohet si i pasuksesshëm nga Kryesia e Degës.

5. Mbledhja e seksionit thirret nga kryetari, ose 1/4 e anëtarëve. Mbledhja thirret të paktën një herë në dy muaj.

6. Seksioni:

- a. organizon veprimtarinë politike në territorin e tij në përputhje me orientimet dhe qëndrimet e shpalluara të PDSH-së;
- b. bën pranimin e anëtarëve të rinj të PDSH-së;
- c. bën propozime për kandidatura për drejtues dhe përfaqësues lokalë të Partisë, për deputetin e pushtetarë lokalë etj.;
- d. i bën sugjerime dhe propozime Degës/Grupseksionit për çdo problem që gjykon se është në interes të Partisë.

dh. Bën listën e simpatizantëve të PD që banojnë në territorin e seksionit.

Neni 28 Grupseksioni

1. Grupseksioni, ushtron veprimtarinë e tij mbi bazë njësisish kompakte territoriale. Ai përbëhet nga seksionet e përfshira në territorin e ndarjes përkatëse. Si rregull, një grupseksion korrespondon me jo më pak se 5 (pesë) seksione, apo me ndarjen e rajoneve në zonat urbane, apo me ndarjen e njësive administrative në zonat rurale. Kryesia e Degës vendos për ngritjen dhe ndarjen e grupseksioneve brenda Degës, si dhe përcakton shtrirjen territoriale të tij.
2. Grupseksioni drejtohet nga kryetari dhe sekretari, si dhe nga 1 deri në 2 nënkryetarë.
3. Kryesia e Grupseksionit përbëhet nga:
 - a. kryetari, sekretari e nënkryetari/ët i/e grupseksionit;
 - b. kryetarët, nënkryetarët e sekretarët e seksioneve përbërëse;
4. Kryetar, sekretar si dhe nënkryetarët e grupseksionit zgjidhet me votim të fshehtë, sipas parimit “ Një anëtar; Një votë” nga të gjithë antarët e seksioneve në përbërje të tij, ndërmjet më shumë se një kandidature. Të drejtën për të propozuar kandidatë e kanë 1/5 e anëtarëve të seksioneve që përfshihen në atë grupseksion, Kryesia e Degës, si dhe Kryetari i Degës.
5. Kryesia e Grupseksionit mblidhen me kërkesë të kryetarit të tij, Kryesisë së Degës, Kryesisë së PDSH, ose edhe me kërkesë të jo më pak se 1/4 të anëtarëve të tij.
6. Grupseksioni:
 - a. koordinon veprimtarinë politike të partisë në seksionet e tij përbërëse sipas detyrave të Kryesisë së Degës dhe organeve qendrore të Partisë;
 - b. propozon kandidaturat që do t'i drejtohen organeve vendimmarrëse të Partisë për pushtetarët vendorë;
 - c. i bën sugjerime dhe propozime Degës për çdo problem që gjykon se është në interes të Partisë apo qytetarëve në territorin që mbulon.

Neni 29 Dega e Partisë Demokratike

1. Dega e PDSH formohet/shkrihet me vendim të Kryesisë së PDSH. Ajo funksionon, si rregull, në bazë tënjësive të qeverisjes vendore dhe përbëhet nga grupseksionet dhe seksionet e atyndodhura.

2. Dega drejtohet në periudhën mes kuvendeve nga Kryetari dhe Kryesia e saj.
3. Me vendim të Kryesisë së PDSH, brenda një Degë, mund të ngrihen dy ose më shumë NënDegë, me qëllim organizimin më të mirë të punës brenda partisë. Ato përbëhen nga grupseksionet dhe seksionet e atyndodhura. Për aq sa është e mundur, rregullat për organizimin dhe funksionimin e Degës, janë të zbatueshme edhe për NënDegën. Raporti midis Degës dhe NënDegës, si dhe rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e NënDegës përcaktohen me udhëzim të Kryesisë së PDSH.

Neni 30

Degët e Partisë Demokratike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Kryesia e PDSH vendos krijimin e Degës së Partisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar edhe zonën apo shtetin që mbulon. Një Degë mund të mbulojë një shtet apo disa shtete. Në rastin kur ka një numër të lartë të shtetasve shqiptarë që jetojnë brenda një shteti, mund të krijohen dy ose më shumë Degë, sipas Rajoneve përkatëse.
2. Një Degë e krijuar sipas pikës 1, mund të organizohet në NënDegë, Grupseksione dhe seksione. Për aq sa është e mundur, grupseksionet i referohen një qarku brenda territorit të Shqipërisë, ndërsa seksionet njësive administrativo-territoriale. Ato duhet të mbulojnë të gjithë territorin përkatës të shtetit ku jetojnë dhe respektojnë edhe ligjet dhe rregullat përkatëse të atij shteti.
3. Degët e PD jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizohen dhe funksionojnë për aq sa është e mundur sipas rregullave që ky Statut përcakton për Degët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Organizimi dhe funksionimi i detajuar i tyre përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të PDSH-së.
4. Degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përfaqësohen me kandidatë në të gjitha organet drejtuese të Partisë, duke përfshirë Kuvendin Kombëtar, Këshillin Kombëtar dhe Kryesinë e PDSH-së. Ato gjithashtu përfaqësohen me kandidatët e tyre edhe në listat e Partisë Demokratike për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Numri i përfaqësimit është gjer në 15 % të numrit të përgjithshëm në secilin organ apo në listë.

Neni 31

Kuvendi i Degës së PD

1. Kuvendi i Degës është organi më i lartë i saj. Kuvendi i Degës përbëhet nga:

- a) Kryesia e Degës;
- b) Kryetarët dhe sekretarët e grupseksioneve të Degës;
- c) Kryetarët dhe sekretarët e të gjithë seksioneve të Degës.
- d) Drejtuesit e Departamenteve, sekretarët e Degës, si dhe Sekretari i Diasporës së Degës;
- e) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, që përfaqësojnë Degën ose janë me banim në degën përkatëse;
- ë) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë, që përfaqësojnë Degën ose janë me banim në degën përkatëse;
- f) Kryetarët e Bashkive të Degës, Prefekti, Kryetari i qarkut, dhe kryetarët ose anëtarët e këshillave bashkiak apo të qarkut, anëtarë të PD;
- g) Përfaqësues të zgjedhur prej organizatave partnere, LDG dhe FRPD, etj. Numri i përfaqësuesve për secilën organizatë partnere është deri në 10 % e numrit përgjithshëm të gjithë anëtarëve të përcaktuara në shkronjat e mësipërme të kësaj pike.

2. Kuvendin e Degës e thërret Kryesia e Degës pasi ka informuar paraprakisht Kryesinë e PDSH. Ai mund të thirret edhe kur e kërkon 1/4 e anëtarëve të degës së Partisë ose 1/4 e anëtarëve të kuvendit të degës. Në këtë rast caktimi i datës dhe i rendit të ditës duhet të bëhet jo më vonë se një muaj nga depozitimi i kërkesëstek Kryetari i Degës. Njoftimi i datës dhe i rendit të ditës në cdo rast duhet të bëhet 5 ditë përpara mbajtjes së Kuvendit të Degës.

3. Kuvendi i Degës së PDSH, me propozim të kryesisë miraton komisionin e mandateve, sekretarinë e kuvendit dhe anëtarët e komisionit të numërimit të votave.

4. Kuvendi i Degës së PDSH zgjedh Kryesinë e Degës, vendos për çështje të rëndësishme të saj, si dhe përmbush çdo detyrë tjetër të caktuar me vendim të Kryesisë së PDSH. Ai ka të drejtë t'i adresojë kërkesa organeve qendrore të PD për çështje që e gjykon të arsyeshme.

Kur Kuvendi është i mbledhur, të drejtën për të bërë propozime dhe kërkesa për mocion për çështje të veçanta, e kanë Kryesia e PD, kryesia e degës, ose pesëmbëdhjetë përqind e anëtarëve të pranishëm të kuvendit me të drejtë vote.

5. Kuvendi i Degës së PD, me propozim të Kryesisë së PDSH, Kryesisë së Degës, ose të 1/4 së anëtarëve të tij, mund të shkarkojë sipas rastit, Kryetarin e Degës ose Kryesinë e saj, kur "pro" shkarkimit votojnë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Degës, në prani të më shumë se 2/3 së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Degës.

Neni 32
Kryesia e Degës së Partisë

1. Kryesia e Degës është organi më i lartë për drejtimin e Degës së Partisë ndërmjet dy Kuvendeve. Ajo vendos për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë ekskluzive e Kuvendit të degës apo e organeve qendrore të PDSH.

a) Kryesia e Degës përbëhet nga 17-27 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Degës sipas përcaktimit që i bën këtij numri, për secilën degë, Kryesia e PDSH. Kryetari dhe Sekretari i Degës bëjnë pjesë në këtë numër. Si anëtarë të Kryesisë së Degës me të drejta të plota mbi këtë numër përfshihen edhe kryetarët vendorë të organizatave partnere të PDSH, deputetët e PD-së të zgjedhur në territorin e Degës apo të caktuar nga Kryesia e PDSH-së për të mbulur territorin e Degës, anëtarët e Këshillit Kombëtar me banim në degë, sekretari i Diasporës për Degën, Kryetarët e Bashkisë dhe/ose Kryetarët e Këshillit Bashkiak, kur i përkasin PD, si dhe këshilltarët bashkiak të PD.

b) Kryesia e Degës zgjidhet çdo katër vjet me votim të fshehtë nga Kuvendi i Degës. Numri i kandidatëve që i nënshtrohet votimit, duhet të jetë të paktën dy herë më i madh se numri i vendeve në kryesi.

c) Numri i grave dhe vajzave fituese të jetë gjer në 40 % të numrit të anëtarëve të Kryesisë që del prej votimit. Në rast se ky kriter nuk plotësohet në renditjen e dalë pas votimit, atëherë renditja e tyre veçohet nga ajo e përgjithshmja, deri në plotësimin e numrit të kërkuar sipas kësaj pike.

2. Kryesia zgjedh nga përbërja e saj nënkryetaret e Degës të cilët ndihmojnë kryetarin në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Ajo miraton kandidaturat alternative që i dërgohen Kryesisë së Partisë për sekretarin e degës, zgjedh sekretarët funksionalë, kryetarin e bordit financiar dhe vendos për ngritjen e departamenteve apo bordeve sipas nevojave, si dhe për drejtuesit e tyre.

3. Kryesia e Degës ka për objekt dhe kompetencë edhe:

a) Të drejtojë dhe organizojë të gjithë veprimtarinë e Partisë në territorin ku vepron në përputhje me statutin e rregulloret e PDSH, aktet e nxjerra nga organet qendrore të Partisë, si dhe vendimet e detyrat e lëna nga Kuvendi i Degës së PDSH;

b) Të ndërhyjë në rastet e shkeljes së akteve që rregullojnë funksionimin e brendshëm të PDSH nga seksionet, grupseksionet dhe të përcaktojë rregullat e procedurat për normalizimin e tyre;

c) Të organizojë dhe drejtojë zgjedhjet në strukturat lokale të Partisë si dhe fushatat elektorale e referendare;

d) Të formulojë dhe të paraqesë para organeve eprorë kërkesat dhe propozimet në emër të Degës së Partisë;

- e) Të miratojë kandidaturat me konkurrentë alternativë për personat që zgjidhen e emërohen si poste politike të Partisë dhe kur një gjë e tillë nuk është kompetencë e kuvendit të degës;
- f) Kryesia e Degës është përgjegjëse për veprimtarinë koherente të strukturave në varësi të saj, me veprimtarinë e përgjithshme të partisë në çështjet e organizimit, veprimtarive politike publike, vecanërisht të fushatave elektorale;
- g) propozon ngritjen e NënDegëve në territorin që mbulon Dega, duke përcaktuar edhe kufinj të mbulimit për secilën NënDegë.

4. Mbledhja e kryesisë thirret nga kryetari të paktën një herë në muaj.

Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së kryesisë së degës për probleme të vecanta e kanë edhe 1/4 e anëtarëve të kryesisë. Në këtë rast kryetari njofton datën e mbledhjes jo më vonë se dhjetë ditë nga marrja e kërkesës. Në rast se kryetari i Degës nuk e ushtron detyrën për të thirrur Kryesinë, ajo vetëmbledhet sipas kërkesës së 1/4 të antarëve.

Në çdo rast rendi i ditës dhe materialet e shkruara u njoftohen anëtarëve të Kryesisë jo më vonë se dy ditë para datës së mbledhjes.

5. Kolegji i kryetarëve të grupseksioneve përbëhet nga kryetarët e grupseksioneve dhe drejtohet nga Kryetari i Degës. Kolegji i kryetarëve të grupseksioneve, në varësi të tematikave që diskutohen në mbledhjen e Kryesisë së Degës, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Kryesisë, rast pas rasti apo në mënyrë të përhershme, si anëtar pa të drejtë vote.

Neni 33

Kryetari i Degës së PD

1. Kryetari i Degës së PDSH zgjidhet me votim të fshehtë nga e gjithë anëtarësia e Degës sipas parimit “Një anëtar; një votë” midis jo më pak se dy kandidaturave alternative. Kandidaturat, sipas kriterëve që përcakton Kryesia e PDSH, propozohen nga seksionet, Kryesia e Degës dhe Kryesia e PDSH. Kandidaturat e dala për kryetar të Degës i nënshtrohen një diskutimi dhe vlerësimi nga Kryesia qendrore e partisë, e cila miraton përfundimisht propozimet për kandidaturat.

2. Kryetari i Degës përfaqëson anëtarësinë e partisë në territorin përkatës. Ai thërret dhe drejton mbledhjet e kryesisë, fikson rendin e ditës në bashkëpunim me sekretarin e degës. Ai organizon funksionimin normal të kryesisë dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve dhe orientimeve të saj. Ai përgjigjet për mbarëvajtjen e funksionimit të partisë dhe shprehjen e lirë të çdo anëtari të kryesisë. Në funksion të organizimit dhe mbarëvajtjes së funksionimit të degës,

Kryetari mbledh kolegjin e kryetarëve të grupseksioneve, sa herë e çmon të nevojshme.

3. Kryetari i Degës ndihmohet në ushtrimin e veprimtarisë së tij nga Nënkryetarët e Degës, të cilët mbulojnë dhe janë përgjegjës drejtpërdrejt për veprimtarinë politike në një territor të caktuar elektorale, si dhe për detyra të tjera të caktuara nga Kryesia e Degës.

Neni 34 **Sekretari Politik i Degës**

1. Çdo Degë ka Sekretarin Politik, i cili emërohet nga kryesia e PDSH, sipas procedurave të përcaktuara nga ky Statut dhe Rregullorja e Brendshme.

2. Sekretari Politik ka për detyrë zbatimin e vendimeve të instancave qendrore të Partisë dhe dokumentimin e veprimtarisë së Degës përkatëse. Ai mbikqyr zgjedhjet në parti. Çdo vit ai mban një raport të detajuar të punës së tij në kryesinë e Degës sipas kushteve që përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të partisë.

3. Cdo vit dhe jo më vonë se fundi i tremujorit të parë pas mbylljes së vitit ushtrimor, Sekretari Politik i degës i paraqet kryesisë së degës një raport të veprimtarive, ku vecanërisht përfshihen:

- a) Antarësimet;
- b) Financimi i Partisë;
- c) Funksionimi organizativ i strukturave.

Raporti shqyrtohet në Kryesinë e Degës, dhe bashkë me vërejtjet e mundëshme, sekretari politik i degës e paraqet raportin dhe vërejtjet pranë Kryesisë Qendrore të Partisë. Sekretari Politik i Degës në ushtrimin e detyrës së tij ndihmohet nga Sekretarët Funksionalë të Degës, të cilët zgjidhen nga Kryesia e Degës. Sekretarët Funksionalë, mbulojnë fushat respektive sipas organizimit të Sekretarëve Funksionalë të PDSH-së.

Neni 34/1 **Sekretari i Diasporës në degët e PDSH-së**

1. Në çdo degë të PDSH-së krijohet funksioni i Sekretarit të Diasporës së Degës.

2. Sekretari i Diasporës së Degës zgjidhet nga Kryesia e Degës, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të PDSH-së.

3. Sekretari i Diasporës së Degës ka për detyrë:

- a) të identifikojë anëtarët, simpatizantët dhe votuesit e PDSH-së që jetojnë jashtë vendit dhe kanë lidhje territoriale me degën përkatëse;
- b) të bashkërendojë komunikimin ndërmjet degës në Shqipëri dhe strukturave të PDSH-së jashtë vendit;
- c) të ndihmojë procesin e informimit, regjistrimit dhe mobilizimit elektoral të shtetasve shqiptarë jashtë vendit;
- d) të raportoje periodikisht pranë Kryesisë së Degës mbi ecurinë e procesit të identifikimit dhe realizimin e objektivave.

4. Çdo degë e PDSH-së përcakton objektiva periodike për identifikimin, kontaktimin dhe mobilizimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, sipas udhëzimeve të organeve qendrore të PDSH-së.

Neni 35 **Departamentet**

1. Pranë çdo Dege të PDSH-së ngrihen dhe funksionojnë departamentet, në përbërje të të cilit zgjidhen individë me reputacion të lartë, personalitete të fushave të ndryshme të njohur për aktivitetin e tyre publik dhe promovimin e vlerave të qendrës së djathtë.

2. Departamentet janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe qëndrimeve sektoriale vendore, si dhe kontribuojnë me opinione dhe bashkëpunojnë në hartimin e platformave, strategjive dhe programeve sektoriale, të cilat përfshihen në programin elektoral, programin e qeverisjes dhe veprimtarinë politike të PDSH-së. Departamentet mbikqyren nga nënkryetarët e degës të cilët sigurojnë koordinimin e tyre me veprimtarinë politike që ndërmerr Kryesia e Degës Ata përgjigjen për këtë detyrë përpara Kryetarit dhe Kryesisë së Degës.

3. Anëtarët e Departamenteve miratohen me vendim të Kryesisë së Degës. Ata zgjedhin kryetarin e departamentit cili miratohet nga Kryesia e Degës. Fusha e veprimtarisë që mbulojnë Departamentet dhe numri i tyre në një Degë caktohen sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara me vendim të Kryesisë së PDSH-së.

Neni 36 **Financimi i strukturave vendore të PD**

1. Financimi i strukturave vendore bëhet nga:

- a. shuma në formë granti që akordon kryesia qendrore;
- b. kuotizacioni i anëtarësisë së territorit përkatës, të cilat shpërndahen sipas niveleve të ndryshme të organizimeve territoriale sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren financiare;

- c. kontributi që derdhen të zgjedhurit vendor e në qendër, shumë e cila përcaktohet nga kryesia degës;
- d. burime të tjera financiare që autorizon ligji për partitë politike.

2. Kryetari i bordit financiar të Degës (trezorieri) emërohet nga kryesia. Ai është përgjegjës përpara kryesisë për fondet që ka në ngarkim.

3. Bordi financiar i organeve vendore të partisë përbëhet nga një numër anëtarësh sipas vendimit të kryesisë përkatëse. Ai zbaton me rigorozitet në ushtrimin e detyrave të tij rregulloren e brendshme financiare të Partisë.

Neni 37

Aparati Administrativ

Në përputhje me mundësitë e saj financiare, Dega e PD ndërton aparatin e saj administrativ i cili funksionon sipas një rregulloreje të brendshme. Kryetari i Degës emëron dhe shkarkon personelin e kësaj administrate.

Neni 38

Paraqitja e kandidaturave për pushtetin vendor

Kandidaturat për zgjedhjet në këshillat e organeve të qeverisjes vendore miratohen nga kryesia e degës përkatëse të PD. Në rastet kur brënda juridiksionit territorial të njësisë së qeverisjes vendore ushtrojnë veprimtarinë më shumë se një degë e PD, lista përfundimtare e kandidaturave miratohet nga Kryesia e PDSH sipas propozimeve nga kryesitë e degëve përkatëse, duke synuar përfaqësim proporcional të tyre. Lista e këshilltarëve e miratuar sipas kësaj dispozite duhet të synojë përzgjedhje të personaliteteve me autoritet të lartë politik, profesional dhe shoqëror.

Neni 39

E drejta e informimit

Organet Qendrore të PD kanë të drejtë t'u kërkojë organeve vendore çdo informacion lidhur me jetën e Partisë që i duket i nevojshëm. Këtë të drejtë e kanë edhe organet drejtuese vendore ndaj strukturave nën varësi.

Neni 40

E drejta e ndërhyrjes

1. Në rast se Kryetari dhe/ose Kryesia e Degës thyejnë rëndë ose në mënyrë të përsëritur Statutin, dhe aktet e tjera të nxjerra nga organet qendrore në zbatim të tij, ose kur paralizohet veprimtaria normale e PD, Kryesia e PDSH ka të

drejtën e ndërhyrjes dhe, në raste të vecanta, të pezullimit të Kryetarit. Në këtë rast, drejtimin e degës e bën një nga Nënkryetarët e caktuar nga Kryesia e PDSH-së, për aq kohë sa zgjat pezullimi i Kryetarit. Kur masa e pezullimit merret ndaj Keyesisë së Degës, kjo e fundit i nënshtrohet votëbesimit në bllok në Kuvendin e Degës, brënda 30 ditëve nga marrja e masës së pezullimit.

1/1. Pezullimi i kryetarit sipas pikës 1, nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë. Në rast se rrethanat diktojnë që pezullimi është i nevojshëm për një kohë më të gjatë, atëherë Kryesia e PDSH procedon me shkarkimin e Kryetarit të Degës, dhe komandimin e një kryetari të ri në detyrë deri në organizimin dhe përfundimin e zgjedhjes së Kryetarit të ri sipas rregullave të këtij Statuti.

2. Kryesia e PDSH ka të drejtën e ndërhyrjes edhe në rastet e zbatimit të gabuar të akteve dhe procedurave në funksionimin e degëve të Partisë.

3. Kryesia e PD ndërhyr në mënyrë të veçantë në rastet e konflikteve në procesin e propozimit të kandidaturave elektorale. Këto të drejta i ka edhe Kryesia e Degës ndaj seksioneve e grupseksioneve që ndodhen në territorin e saj.

KREU IV ORGANET QENDRORE TË PARTISË

Neni 41

Organizimi i Përgjithshëm i Partisë Demokratike

Organet qendrore të PD janë:

- a) Kuvendi i Partisë;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Kryetari;
- d) Kryesia;
- e) Sekretari i Përgjithshëm;
- f) Sekretariati i Partisë.

Neni 42

Kuvendi Kombëtar i Partisë

1. Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë, që përbëhet nga 1100 (një mijë e njëqind) anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendet e degëve të PDSH sipas një numri të përcaktuar për çdo degë nga Kryesia e PDSH. Listën e kandidaturave për delegatë në Kuvendin Kombëtar e paraqitet në Kuvendin e Degës nga Kryesia e saj. Janë delegatë të Kuvendit Kombëtar:

- a) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike;

- b) Anëtarët e Kryesisë së Partisë Demokratike;
- c) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë;
- ç) Antarët e qeverisë që janë antarë të PDSH-së;
- d) Kryetarët e Bashkive, Prefekti, Kryetari i Qarkut, antarë të PDSH-së;
- dh) Një numër përfaqësuesish të organizatave partnere të LDG dhe FRPD ku përfaqësimi do të jetë, 10 për qind të numrit të përgjithshëm për LDG dhe 10 për qind të numrit të përgjithshëm për FRPD, të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar. Organizatat e tjera partnere përfaqësohen me një numër delegatësh gjer në 2 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar, sipas numrit konkret që njoftohet nga Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së.

Mandati i antarit të Kuvendit është i vlefshëm për katër vjet.

2. Kuvendi Kombëtar ka mandat katër vjeçar dhe mbledhet sa herë kërkohet sipas dispozitave të këtij Statuti. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, si rregull, e merr Kuvendi Kombëtar, Këshilli Kombëtar ose, në pamundësi për t'u mbledhur ky i fundit, atë e thërret Kryesia e PDSH-së me propozim të Kryetarit të PDSH-së.

Kuvendi mund të mbledhet edhe kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. E drejta e antarëve për të thirrur Kuvendin Kombëtar është e pakushtëzuar dhe e vetëmjaftueshme.

Data e zhvillimit të Kuvendit dhe rendi i ditës njoftohen nga thirrësit të paktën një muaj përpara ditës së parë të Kuvendit. Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të punimeve të tij me propozimin, sipas rastit, të Kryetarit të Partisë, ose të grupit nismëtar kur Kuvendi thirret nga antarësia e PDSH-së apo delegatët e Kuvendit të saj.

Verifikimi i përmbushjes së kërkesave statutores për thirrjen e Kuvendit nga organet qendrore apo nga antarësia sipas kësaj dispozite, kryhet nga Komisioni që drejton punimet e Kuvendit. Në rast kundërshtimi të thirrjes së mbledhjes së Kuvendit nga antarësia, kundërshtuesit kanë të drejtë të jenë pjesë e komisionit për verifikimin e thirrjes dhe të kuorumit të mbledhjes së Kuvendit. Pas verifikimit të thirrjes sipas statutit, komisioni deklaron thirrjen e rregullt dhe vazhdon me verifikimin dhe deklarimin e pranisë së kuorumit të nevojshëm për mbledhjen e Kuvendit.

3. Kur kuvendi thirret nga 1/4 e antarësisë apo 1/4 e delegatëve të Kuvendit, asnjë nga organet e tjera qendrore të PDSH-së nuk ka të drejtë të thërrasë një mbledhje tjetër të Kuvendit, pa përfunduar mbledhja e thirrur. Asnjë prej organeve qendrore të partisë, nuk mund të marrë vendime që pengojnë mbajtjen e mbledhjes së thirrur të Kuvendit Kombëtar, apo të ndryshojë rendin e ditës së përcaktuar nga thirrësit e mbledhjes së Kuvendit sipas kësaj pike.

Neni 43

Kompetencat e Kuvendit Kombëtar

1. Kuvendi Kombëtar ka kompetencë për:

- a) miratimin e Statutit të PDSH dhe ndryshimin e tij;
- b) miratimin e programit të Partisë dhe linjave kryesore të politikës së saj, të cilat janë bazë pune për të zgjedhurit e PDSH-së në nivel qendror e vendor, si dhe për pushtetin ekzekutiv të drejtuar prej saj; Mbikëqyrje mbi veprimtarinë dhe marrjen e masave ndaj organeve qendrore të partisë;
- c) zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, si dhe shkarkimin e tyre me mocion mosbesimi, sipas rastit, nga pesëmbëdhjetë përqind e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar apo të Këshillit Kombëtar, ose me propozim të Kryesisë së PDSH;
- ç) shkarkimin e Kryetarit të Partisë mbi bazën e një kërkesë të mbështetur nga të paktën pesëmbëdhjetë për qind e delegatëve të Kuvendit, ose të një kërkesë apo një mocioni mosbesimi të propozuar nga të paktën njëzet përqind e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar, ose sipas propozimit të një grupi deputetësh të PDSH jo më të vogël se numri i nevojshëm për të formuar grup parlamentar sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Kuvendi, në rast shkarkimi të kryetarit sipas kësaj dispozite, mund të vendosë të ratifikojë vendimmarrjen nëpërmjet një referendumi në të gjithë antarësinë e PDSH-së. Kuvendi mund të vendosë që kërkesën apo mocionin për shkarkim ta dërgojë drejtpërdrejtë për votim në referendum;
- d) zgjedhjen e Kryetarëve të Nderit të PDSH, të cilët janë anëtarë me të drejtë vote në organet qendrore të PDSH-së për gjithë jetën;
- dh) shpërndarjen e Partisë ose bashkimin me një ose disa parti të tjera.

2. Të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, një grup deputetësh të PDSH jo më i vogël se numri i nevojshëm për të formuar grup parlamentar sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë përqind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote.

Neni 44

Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar, në përputhje me programin, Statutin dhe vendimet e Kuvendit Kombëtar, drejton veprimtarinë politike të Partisë në periudhën midis dy mbledhjeve të Kuvendit. Ai merr të gjitha vendimet e rëndësishme politike

që mund të kërkojnë rrethanat dhe kur ato nuk janë parashikuar në këtë Statut si e drejtë vetëm e Kuvendit.

2. Këshilli Kombëtar përbëhet nga Kryetari i PDSH-së dhe jo më pak se 200 anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Kuvendi Kombëtar. Jashtë këtij numri, janë anëtarë të Këshillit Kombëtar pa iu nënshtruar procesit të votimit, Deputetët e PDSH në detyrë, Kryetarët e Degëve të PDSH, kryetarët e Bashkive që i përkasin Partisë Demokratike, ish- Presidentët, ish-Kryeministrat, ish-Kryetarët e Kuvendit dhe ish-Kryetarët e PDSH-së, që janë anëtarë të PDSH-së në momentin e mbledhjes së Këshillit Kombëtar, si dhe një numër gjer në 15 % të anëtarëve të zgjedhur, të cilët vijnë si propozime nga diaspora dhe/ose Degët e PD jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista emërore e këtyre të fundit, paraqitet nga Kryetari për miratim me vendim të Kryesisë së PDSH.

3. Janë automatikisht kandidatë për Këshillin Kombëtar:

- a) anëtarët në detyrë të Kryesisë së Partisë;
- b) ministrat në detyrë, anëtarë të PDSH-së;

4. Kuvendi Kombëtar i zgjedh antarët e Këshillit Kombëtar me votim të fshehtë nga një listë e propozuar nga Kryetari i Partisë, pas miratimit në Kryesinë e Partisë. Miratimi i listës nga Kryesia dhe publikimi i saj bëhet jo më vonë se pesë ditë përpara ditës së votimit. Numri i kandidatëve duhet të jetë jo më pak se dyfishi i numrit të vendeve që do të shpallen fitues. Numri i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Kombëtar nga gjina më pak e përfaqësuar duhet të jetë gjer në 40 %, ndërkohë që numri i të rinjve deri nën moshën 35 vjeç nuk duhet të jetë më pak se 15%. Nëse kuotat e mësipërme nuk plotësohen nga renditja e dalë pas votimit, atëherë renditja e tyre veçohet nga ajo e përgjithshmja, deri në plotësimin e numrit të kërkuar.

5. Këshilli Kombëtar drejtohet nga Kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Kombëtar, mes të paktën dy kandidaturave alternative.

6. Këshilli Kombëtar, si rregull, mblidhet jo më pak se dy herë në vit. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës duhet t'u njoftohen anëtarëve jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Mbledhjen e Këshillit Kombëtar e thërret Kryetari i Këshillit Kombëtar, ose Kryesia e Partisë me propozim të Kryetarit të Partisë. Këshilli Kombëtar mund të mblidhet edhe nëse e kërkojnë $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të tij, duke përcaktuar rendin e ditës. Në këtë rast, Kryetari i Këshillit Kombëtar e thërret mbledhjen jo më vonë se dy javë nga data e depozitimit të kërkesës. Nëse Kryetari i Këshillit nuk e thërret mbledhjen, Këshilli vetëmbledhet në ditën e fundit të këtij afati.

7. Të drejtën për t'i propozuar vendime Këshillit Kombëtar e kanë Kryetari i Partisë, Kryesia e Partisë, Kryetari i Këshillit Kombëtar, si dhe të paktën 1/4 e anëtarëve të tij. Jo më pak se 5% e anëtarëve të Këshillit Kombëtar kanë të drejtën që, në çdo kohë, të propozojnë kandidatë alternativë për çdo funksion politik që zgjidhet nga Këshilli Kombëtar. Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë të thjeshtë. Në rastin e masave disiplinore, vendimet e Këshillit Kombëtar merren me 2/3 e votave. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar nuk mund të zhvillohen pa praninë e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve.

Neni 45

Kompetencat e Këshillit Kombëtar

Këshilli Kombëtar, ushtron këto kompetenca:

- a) vendos me votim të fshehtë për zgjedhjen me kandidatura alternative ose shkarkimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm; Nënkryetarëve të zgjedhur të Partisë; Anëtarëve të zgjedhur të Kryesisë së PDSH-së; Sekretarëve funksionalë; Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Apelit; si dhe Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit Financiar të Partisë;
- b) miraton listën përfundimtare të kandidaturave elektorale sipas propozimit të Kryesisë së PDSH-së;
- ç) miraton strategjitë dhe programin elektoral e politik të PDSH-së;
- d) miraton koalicionet para apo pas zgjedhore;
- d/1) mban qëndrimin e partisë lidhur me rezultatin e zgjedhjeve të përgjithshme apo lokale, si dhe shkallën e respektimit të standradeve të zgjedhjeve të lira e të ndershme. Qëndrimi i Këshillit Kombëtar ka efekt të menjëhershëm dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha organet drejtuese të Partisë Demokratike. Ai ratifikohet në mbledhjen më të parë të Kuvendit Kombëtar të PDSH-së;
- dh) vendos masat disiplinore për anëtarët e Këshillit Kombëtar apo Kryesisë së PDSH-së;
- e) miraton Rregulloren e Brendëshme të PDSH-së sipas e propozimit nga Sekretariati dhe Kryesia e PDSH.

Neni 46

Kryetari i Partisë

1. Kryetari i Partisë siguron zbatimin e vendimeve të organeve kolegjiale qendrore të Partisë. Ai përfaqëson Partinë në të gjitha veprimtaritë publike e politike, të brendshme dhe ndërkombëtare. Kryetari emëron zëdhënësin e Partisë, si dhe sekretarin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

2. Kryetari i Partisë ndihmohet nga Nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm. Kryetari i Partisë, në varësi të problematikave apo çështjeve specifike, mund të ngrejë struktura ndihmëse apo të caktojë koordinatorë që merren me shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre, të cilët në asnjë rast nuk mund t'u mbivendosen organeve të Partisë sipas këtij Statuti.

3. Kryetari i Partisë në përmbushje të funksioneve të tij dhe garantimit të mbarëvajtjes së punës në parti, nxjerr urdhra dhe udhëzime, në bazë dhe për zbatim të vendimeve të organeve kolegjiale qendrore të Partisë.

4. Kur Kryetari mungon përkohësisht në detyrë, ai zëvendësohet nga një prej Nënkryetarëve të caktuar me delegim nga Kryetari.

5. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, funksionet e Kryetarit ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

6. Kryetari i Partisë zgjidhet me votim të fshehtë të gjithë anëtarëve të PDSH, sipas parimit “Një anëtar, Një votë”. Modalitetet e procesit përcaktohen nga Rregullorja e Brendshme e PDSH. Mandati i Kryetarit është katër vjet.

7. Mandati i Kryetarit mbaron në mënyrë të parakohshme në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) shkarkohet;
- c) vdes ose humbet aftësinë për të vepruar;

8. Në rast se pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve të përgjithëshme për Kuvendin, Partia nuk rezulton forcë fituese qeverisëse, mandati përfundon menjëherë dhe automatikisht për shkak të Statutit. Në këtë rast, kryetarit që i përfundon mandati, nuk i lejohet kandidimi në zgjedhjet pasardhëse për kryetar partie.

9. Pas zgjedhjeve të përgjithëshme për pushtetin vendor, Kryetari votëbesohet me votë të fshehtë në Kuvendin Kombëtar. Kryetari quhet i votëbesuar kur kanë votuar “pro” jo më pak se 70% e antarëve që kanë marrë pjesë në votim.

Neni 47

Kryesia e Partisë

1. Kryesia e Partisë drejtohet nga Kryetari i Partisë dhe përbëhet nga:

- a) Kryetari i Partisë;
- b) Nënkryetarët e Partisë,
- c) Sekretari i Përgjithshëm;
- d) Kryetari i Këshillit Kombëtar;

- e) kryetarët e organizatave partnere të Partisë Demokratike;
- f) Anëtarë, përfaqësues të Diasporës, të cilët propozohen nga Kryetari i Partisë dhe caktohen nga Kryesia e PDSH menjëherë pas konstituimit të saj.
- g) Njëzet anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar, sipas një liste të miratuar në Kryesinë e partisë me propozim të Kryetarit të Partisë ose kandidaturave të mbështetura nga jo më pak se 15% e anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Deri në 40 % e antarëve të zgjedhur të Kryesisë duhet të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar.

2. Anëtari i Kryesisë nuk mund të mbajë më shumë se një mandat tjetër përveç atij të fituar sipas këtij neni.

3. Në rast se pas përcaktimit të përbërjes së Kryesisë së PDSH sipas pikës 1 të këtij neni, deputetë antëtarë të Kryesisë së Grupit Parlamentar të PDSH, nuk rezultojnë anëtarë të saj, këta të fundit kooptohen si anëtarë të saj me të drejta të plota, deri në përfundimin e mandatit të tyre parlamentar, ose zgjedhjen e tyre sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 48

Kompetencat e Kryesisë

1. Kryesia e PDSH-së ndjek dhe siguron zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi dhe Këshilli Kombëtar. Kryesia vendos për të gjitha çështjet që nuk janë e drejtë ekskluzive sipas këtij statuti e Kuvendit Kombëtar dhe Këshillit Kombëtar, si dhe miraton marrëveshjet politike.

Veçanërisht, ajo ushtron këto përgjegjësi:

- a) emëron sekretarët politik të Degëve të PDSH-së, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) miraton kandidatët për Kryetar të Degëve të PDSH-së;
- c) i propozon Këshillit Kombëtar listën përfundimtare të kandidaturave elektorale, sipas parashikimeve të këtij Statuti;
- ç) ka të drejtë të vendosë për thirrjen e Kuvendit për zgjedhje të reja të Degës së Partisë dhe caktimin e organeve drejtuese të përkohshëm të degës në përputhje me këtë Statut;;
- d) miraton strukturën organike të PDSH-së dhe atë të pagave;
- dh) ndërhyr dhe mund të refuzojë kandidaturat e përzgjedhura nga organet vendore të Partisë që janë bërë në kundërshtim me kriteret dhe rregullat statutores;
- e) vendos ngritjen e komisioneve të përhershme dhe të përkohëshme ose departamenteve, sipas nevojave të PDSH.

Numri i departamenteve, fusha e veprimtarisë që mbulojnë, si dhe ndarja e anëtarëve në to, përcaktohen me vendim të Kryesisë, me propozim të Kryetarit të Partisë. Departamentet janë përgjegjëse për përgatitjen e platformave, opinioneve, strategjive dhe programeve sektoriale, të cilat shërbejnë për formulimin e programit elektorale, programit të qeverisjes dhe veprimtarinë politike të PDSH-së. Departamentet sigurojnë koordinimin e veprimtarisë në fushat që mbulojnë ndërmjet partisë dhe grupit të saj parlamentar. Departamentet përgjigjen për punën e tyre pranë Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Çdo vit ato hartojnë një raport për veprimtarinë vjetore, i cili i paraqitet për njohje Kryesisë së Partisë. Departamentet zgjedhin drejtuesit e tyre. Një nga nënkryetarët e partisë bashkërendon punën e departamenteve.

2. Të drejtën për të kërkuar thirrjen e mbledhjes dhe për të propozuar vendime Kryesisë së Partisë e kanë Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm ose 1/5 e anëtarëve të Kryesisë. Vendimet në Kryesi merren me shumicë të thjeshtë të votave në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Kryesisë. Në rast se nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, atëherë mbledhja vijuese e saj për të njëjtin rend dite, shtyhet për një ditë tjetër për të njëjtin rend dite.

Neni 49

Grupi Parlamentar i Partisë

1. Grupi Parlamentar i PDSH drejtohet nga Kryetari i Grupit dhe përbëhet nga deputetët e zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë nën siglën e Partisë si dhe deputetë që i bashkëngjiten gjatë legjislaturës përkatëseve me vendim të Grupit. Bashkimi dhe largimi prej Grupit Parlamentar bëhet sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

2. Grupi Parlamentar i PDSH:

- a) përfaqëson në Parlament PDSH dhe siguron aty mbrojtjen e platformës, programit dhe interesave të PDSH;
- b) harton programin dhe përcakton mënyrën e veprimit e të angazhimit të deputetëve të tij në Parlament dhe në zonat elektorale përkatëse;
- c) vendos për ndarjen e anëtarëve të tij në komisionet parlamentare;
- d) harton rregulloren e funksionimit të Grupit Parlamentar;
- e) i propozon Këshillit Kombëtar për çështjet që janë në kompetencën e këtij të fundit.

Neni 50
Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretariati

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin e partisë, si dhe për funksionimin e përditshëm të saj.
2. Ai organizon dhe ndjek zbatimin e akteve të nxjerra nga organet qendrore të partisë në degët e PDSH. Ai ndihmohet në punën e tij nga Sekretariati i cili përbëhet nga sekretarët funksionalë të cilët propozohen nga Kryetari i Partisë me miratimin e Kryesisë, sipas fushave të veprimtarisë që vlerësohen të nevojshme. Detyrat dhe përgjegjësitë e detajuara të Sekretarëve funksionale përcaktohen në Rregulloren e PDSH.
3. Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet çdo katër vjet.

Neni 51
Nënkryetarët e Partisë

1. PDSH ka nënkryetarë të cilët zgjidhen sipas përcaktimeve të këtij Statuti.
2. Nënkryetar të Partisë janë edhe kryetari i Grupit Parlamentar, dhe sipas rastit, Kryetari i Kuvendit ose Nënkryetari i Kuvendit që i përket opozitës, që caktohen sipas Rregullores së Kuvendit.

Neni 51/1
Kolegji i Drejtuesëve të Degëve të PDSH

1. Kolegji i Drejtuesëve të Degëve të PDSH, përbëhet nga të gjithë Kryetarët dhe Sekretarët Politik të Degëve të PDSH, dhe është një strukturë drejtuese ndihmëse dhe këshillimore e Kryetarit të Partisë.
2. Kolegji i Drejtuesëve të Degëve të PDSH, ushtron këto përgjegjësi:
 - a) diskuton mënyrën e përmbushjes së detyrave në kuadër të një aksioni apo aktiviteti politik, sipas vendimeve të marra nga organet drejtuese të PDSH-së;
 - b) këshillon Kryetarin e Partisë për ndërmarrjen e aksioneve politike dhe iniciativave që sigurojnë mbarëvajtjen e punës në parti;
 - c) mbështet Kryetarin e Partisë në përmbushjen e detyrave të caktuara nga organet drejtuese të partisë;
 - d) diskuton për format dhe mënyrat e përmirësimit të organizimit dhe punëve në parti.

Neni 51/2
Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës

1. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës është organ konsultativ dhe përfaqësues i diasporës, që ngrihet dhe funksionon pranë Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë.
2. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës drejtohet nga Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe ka në përbërje:
 - a) Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së;
 - b) Të gjithë kryetarët e degëve të PDSH-së në diasporë;
 - c) Drejtuesit e Sekretariatit për Diasporën i PDSH-së;
 - d) Sekretari i Marrëdhënieve Ndërkombëtare i PDSH-së;
 - e) 5 deri në 7 personalitete të shquara shqiptare të diasporës, të cilët emërohen me propozim të Kryetarit të Partisë pas miratimit nga Kryesia e PDSH-së.
3. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës ushtron këto përgjegjësi:
 - a) propozon strategjinë kombëtare të PDSH-së për diasporën;
 - b) bashkërendon organizimin e degëve dhe strukturave të PDSH-së jashtë vendit;
 - c) propozon kandidatura dhe personalitete të diasporës për përfaqësim në organet e PDSH-së dhe në listat elektorale;
 - ç) bashkërendon kontributin e profesionistëve, akademikëve, sipërmarrësve, studentëve dhe personaliteteve të diasporës në programet politike të PDSH-së;
 - d) konsulton Kryesinë e PDSH-së duke i paraqitur asaj raporte periodike mbi gjendjen organizative, anëtarësinë, simpatizantët, nivelin e mobilizimit dhe problematikat e diasporës.
4. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës mbledhet jo më pak se një herë në vit. Ai mund të mbledhet edhe jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Partisë.
5. Organizimi, procedurat e funksionimit, mënyra e raportimit dhe marrëdhëniet e Këshillit Kombëtar të Diasporës me organet e tjera të PDSH-së përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të PDSH-së.

Neni 52
Ngritja e Qëndrave dhe Instituteve të përhershme apo të përkohshme

1. Pranë PD mund të ngrihen Qendra apo Institute të përhershme apo të përkohshme, si njësi kërkimore, këshilluese dhe trajnuese, të fokusuara në kërkimin dhe edukimin politik.

2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre, përcaktohen me udhëzim të Kryetarit të Partisë.

KREU V ORGANET E KONTROLLIT TË PARTISË

Neni 53

Komisioni i organizimit dhe kontrollit të operacioneve elektorale

1. Komisioni i organizimit dhe kontrollit të operacioneve elektorale është një strukturë qendrore e përkohëshme e përbërë nga pesë anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kryesia e Partisë dhe nga radhët e antarësisë së Këshillit Kombëtar, sa herë ka procese zgjedhore në Parti.

2. Komisioni ka autoritetin për përgatitjen dhe organizimin e operacioneve të votimit në nivel kombëtar dhe lokal si dhe siguron regullshmerinë e tyre. Ai ndërhyr në zgjidhjen e çështjeve elektorale në degët e partisë në përputhje me aktet e nxjerra për këtë qëllim. Ai përgjigjet përpara Kryesisë së Partisë.

Neni 54

Komisioni i Apelit dhe Vlerësimit të Statutit

1. Komisioni i Apelit dhe Vlerësimit të Statutit përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombtar.

2. Komisioni shqyrton ankesat nga anëtarët e PDSH kundër masave disiplinore të marra ndaj tyre nga secili organ i partisë, që është kompetent sipas këtij Statuti. Ai siguron gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave të drejtën e anëtarit për një proces të rregullt ligjor. Vendimi i Komisionit është i pa ankimueshem . Kur një Kryesi vendos të marrë një sanksion kundrejt një anëtari që mban një mandat zgjedhor, ekzekutiv ose parlamentar, ai nuk mund të bëhet publik veçse nëse vendos Kryesia e PDSH. Në të gjitha rastet e tjera, Komisioni deklaron vetë publikisht vendimet që merr.

3. Komisioni shqyrton kërkesat për mospërputhje me Statutin të vendimeve të marra nga organet qendrore apo te degëve të Partisë. Ai thërret për dëgjim, sipas rastit, të interesuarit.

4. Komisioni shqyrton çdo kërkesë apo ankesë që ka të bëjë me zbatimin e Statutit dhe rregullave të funksionimit të Partisë mbi një çështje të caktuar dhe

merr vendim përfundimtar mbi atë çështje. Komisioni ka të drejtë të shqyrtojë dhe japë vlerësim përfundimtar edhe mbi interpretimin përfundimtar të dispozitave të Statutit.

KREU VI VEPRIMTARIA EKONOMIKE E PARTISË

Neni 55 Financat e Partisë

1. Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike, si dhe nga çdo burim tjetër që autorizon ai.
2. Masa e kuotës së anëtarësisë përcaktohet nga Kryesia e Partisë. Grumbullimi dhe administrimi i kuotave e kontributeve bëhet konform rregullores së brendshme.
3. Bilancet, ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet, Buxheti Vjetor i Partisë dhe shpërndarja e tij në degët e partisë, bëhen publike në faqen zyrtare në internet të PDSH.

Neni 55/1 Aparati qendror administrativ i partisë

Në përputhje me mundësitë e saj financiare, Partia Demokratike ndërton aparatin e saj qendror administrativ i cili funksionon sipas një rregulloreje të brendshme. Aparati qendror administrativ drejtohet nga Administratori i Përgjithshëm i Partisë, i cili emëron dhe shkarkon personelin e kësaj administrate. Struktura e aparatit qendror administrativ përcaktohet me vendim të Kryesisë së Partisë. Administratori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet me vendim të Kryesisë së Partisë.

Neni 56 Bordi Financiar i Partisë

1. Bordi Financiar i Partisë përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Kryesia e Partisë.
2. Kryetari i Bordit, i zgjedhur sipas këtij Statutit, është përgjegjës për administrimin e fondeve të Partisë. Ai i kërkon Kryesisë të shprehet për projektin e buxhetit dhe jep llogari para saj për zbatimin e këtij buxheti. Bordi

Financiar, paraqet një opinion për projektin e buxhetit dhe propozon për miratim nga Kryesia e Partisë rregulloren e përdorimit të fondeve të partisë.

3. Bordi i administrimit financiar kontrollon përdorimin rigoroz të financave të partisë. Në këtë funksion, ai mblidhet për të dhënë mendim:

a) para dorëzimit të bilancit të partisë në organet kompetente shtetërore dhe të partisë;

b) para paraqitjes së buxhetit në Kryesinë e Partisë.

Ai mund të mblidhet edhe me kërkesën e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij për të nxjerrë rekomandime për administrimin financiar të partisë. Këto rekomandime janë të detyrueshme për Kryesinë e Partisë.

Neni 57

Detyrimet pasurore

1. Kryesia e PDSH nuk mund të marrë përsipër detyrime sipas të cilave anëtarët e saj përgjigjen me pasurinë personale.

2. Për detyrime tregtare ligjore të Partisë, anëtarët e organeve përkatëse përgjigjen vetëm me pasurinë e Partisë.

3. Organet e Partisë janë përgjegjëse për detyrimet e një organi më të ulët vetëm në rastin kur ato e kanë miratuar këtë detyrim.

KREU VII

ORGANIZATAT PARTNERE

Neni 58

Organizatrat partnere

1. Partia ka këto organizata partnere:

a. Forumin Rinor të Partisë Demokratike;

b. Lidhjen Demokratike të Gruas.

c. Grupimin "Dhjetor '90"

2. PDSH mbështet veprimtarinë politike të organizatave partnere në gjithë territorin e vendit.

3. PDSH garanton përfaqësimin e organizatave partnere në të gjitha nivelet e përfaqësimit politik. Përfaqësimi i LDG shkon gjer në 40 %, përveç rasteve kur ligji elektorat përcakton një standard minimum më të lartë. Përfaqësimi i të rinjve garantohet me 15 për qind të të zgjedhurve në Këshillat Vendorë, si dhe me 10 për qind të listës së kandidatëve për në Kuvendin e Shqipërisë.

Përfaqësimi i organizatave të tjera partnere përcaktohet nga Kryesia e PDSH-së dhe mund të shkojë gjer në 2 %. Kandidaturat propozohen në bashkëpunim dhe pasi është marrë mendimi i organizatave partnere.

4. Miratimi i organizatave të tjera bëhet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe duhet konfirmuar nga Kuvendi Kombëtar me ndryshimin përkatës në Statut.

KREU VIII PROCEDURA E MBLEDHJEVE

Neni 59 Garantimi i shprehjes së lirë të çdo anëtari

1. Çdokush nga anëtarët ka të drejtë të shprehë lirshëm mendimin e tij në strukturat dhe organet e PDSH.
2. Kufizimi në kohë dhe numër i diskutimeve në një mbledhje është i mundshëm kur nuk është diskriminues dhe kur këtë e kërkon shumica e anëtarëve me të drejtë vote.
3. Në çdo rast duhet respektuar dhe garantuar shprehja e mendimit ndryshe. Për këtë, kur diskutohen çështje për të cilat ka mendime “pro” dhe “kundra”, të garantohet shprehja e mendimit të pakicës.

Neni 60 Dokumentimi i vendimeve

Vendimet e Kuvendit Kombëtar, Këshillit Kombëtar dhe të Kryesisë së Partisë, dokumentohen, protokollohen dhe arkivohen nga dy persona të caktuar nga vetë organi. Për organet vendore të Partisë ndiqet e njëjta procedurë nga sekretari politik i degës.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 61 Miratimi i akteve zbatuese

Në zbatim të këtij Statuti, Këshilli Kombëtar dhe Kryesia e PDSH, nxjerrin aktet nënstatutore si rregullore, udhëzime, vendime, urdhëresa, etj, të cilat janë të detyrueshme për zbatim. Çdo njeri prej akteve të mësipërme si dhe statutet apo rregulloret e organizatave partnere nuk duhet të bien në kundërshtim me Statutin e PDSH.

Neni 62
Hierarkia e vendimarrjes

1. Hierarkia e vendimeve, të cilat nuk janë ekskluzivitet i një organi të vetëm të PDSH, respekton hierarkinë e organeve të PDSH.
2. Çdo vendimarrje nga një organ i cili merr kompetencat e një organi tjetër të PDSH, përveç rasteve të parashikuara në këtë statut, konsiderohet absolutisht i pavlefshëm dhe passjell përfundimin automatik të mandatit të organit i cili ushtroi kompetenca jo të vetat.
3. Çdo vendimarrje në kundërshtim me vendimet e Kuvendit Kombëtar të PDSH është absolutisht e pavlefshme.

Neni 63
Rishikimi i statutit

1. Ky Statut mund të rishikohet nga Kuvendi i Partisë me shumicën absolute të anëtarëve të tij sipas propozimeve të Kryesisë së partisë ose të një të katërtës së anëtarëve të Këshillit Kombëtar.
2. Në raste të veçanta, me propozim të Kryesisë së Partisë ose të një të katërtës së anëtarëve të Këshillit Kombëtar, ky i fundit mund të miratojë ndryshime statutores, të cilat hyjnë menjëherë në fuqi dhe janë ekzekutive. Për miratimin e tyre duhet të votojnë “pro” jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Ndryshimet e miratuara sipas kësaj pike i nënshtrohen ratifikimit nga Kuvendi Kombëtar i radhës dhe ato bëhen pjesë integrale e Statutit të PDSH. Në rast të mos ratifikimit të tyre, ato e humbasin fuqinë menjëherë.

DISPOZITA TRANZITORE

Neni 64
Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit

1. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti dhe deri në përfundim të zgjedhjes së Kryesisë së PDSH, drejtimi ekzekutiv i partisë bëhet nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit.
2. Mandati i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit, përfundon në momentin që zgjidhet Kryesia e PDSH.

Neni 65
Krijimi i organeve të reja

1. Krijimi i organeve të reja, sipas këtij statuti, fillon menjëherë dhe përfundon jo më vonë se tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij dhe paraprihet nga një proces anëtarësimesh të reja dhe të verifikimit të anëtarësisë ekzistuese.
2. Radha e çeljes së procesit zgjedhor është nga baza në qendër, duke filluar nga seksionet e duke përfunduar te Kryesia e PDSH.
3. Këtyre rregullave nuk i nënshtrohen procesi i zgjedhjes së Kryetarit të Partisë i cili zgjidhet sipas parimit “ një anëtar një votë”.
4. Organet ekzistuese, gjatë fazës tranzitore deri në krijimin e organeve të reja, lidhur me rregullat mbi funksionimin dhe vendimmarrjen e tyre, do të aplikojnë, për aq sa janë të zbatueshme dispozitat e këtij Statuti.

Neni 66
Shfuqizime

Çdo akt i organeve të Partisë Demokratike i ndërmarrë para hyrjes në fuqi të këtij Statuti dhe që bie në kundërshtim me dispozitat e tij, shfuqizohet automatikisht me hyrjen në fuqi të Statutit.

Neni 67
Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 30 Maj 2026